





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Data/Date:	19.09.2024
Nga/Od/From	Baki Beqiri
Për/Za/To:	Fadil Nura, kryetar i Komunës
CC	Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Adelina Spahiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti i takimit për planifikimin e buxhetit – Skenderaj

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks nëri 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me datë 13.08.2024 është hartuar dhe publikuar në web-faqen e komunës, orari i dëgjime dhe takimeve me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2025, linku [» KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 \(rks-gov.net\)](#)

Takimi në Klinikë të Epërme

Takimi publik u hap më 22.08.2024, ora 15:30 qytetarët u njoftuan nga drejtori i financave rreth qarkoreve bixhetore dhe kërkoi që të i japin mendimet dhe kërkesat e tyre të cilat do të inkoorporohen në buxhetin final.

Ljmi [» Dëgjimi i katërt buxhetor është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal. \(rks-gov.net\)](#)

Në Platformën e Konsultimeve Publike: [» KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 \(rks-gov.net\)](#)

KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË

Më datë: 22.08.2024 mbahet konsultimi publik në Klinikë të Epërme, në shkollën “Idriz Berani” Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë të ndryshëm. Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Konsultimi publik filloi në orën 15; 30

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori për buxhet dhe financa z.Ismet Aliu me ç ‘ rast prezantoi buxhetin e mundshëm dhe qarkoret buxhetore si dhe kufijtë konform qarkores buxhetore përfundimtare

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Gentiana Zeqiri: A e keni planifikuar ndriçimin publik në Kline të Ulet, dhe a i keni përfshirë prapë subvencionet tek barazia gjinore.	1.Po ndriçimi do të realizohet, ndërsa në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse do të vendosim për subvencionet
Taulant Kadriu: A kish pas mundësi me i zgjeru kapacitetet esalles Ilaz Kodra edhe me 200 ulese	2.Nuk kemi as buxhet as projekt

Komentet – Janë dhënë gjithsej 3 komente kompetente, 2 do të përfshihen në buxhet

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
Buxheti komunal	Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	F 4 M 16 T 20	Klinikë e Epërme	3 komente, 2 merren parasysh	Njoftimi » KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 (rks-gov.net)

					<p>Lajmi » Dëgjimi i katërt buxhetor është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal. (rks-gov.net)</p> <p>Procesverbali 1887_240918075741_001.pdf (rks-gov.net)</p>
--	--	--	--	--	---

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailat e zyrtarëve. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik


Listat e nënshkrimeve të anëtarëve në takimet e mbajtura

Procesverbali



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.
No. 04-400/01-0045311/24
Data
Data 17.09.2024



Komuna e Skenderajt
Opština Opštine Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal
i diskutimit publik për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2025

Data: 22.08.2024

Ora: 15:00

Vendi: Salla e kuvendit komunal Skenderaj

Të pranishëm: Drejtori i drejtorisë së financave, drejtori i drejtorisë së urbanizimit, 14 persona qytetarë dhe nga Ojq

Përshkrim i përgjithshëm

Ky diskutim publik mbahet konform thirrjes publike nr.02-C50/01-00388731/24 i datës 12.08.2024

Ismet Aliu-drejtor i drejtorisë për buxhet dhe financa: Përshëndetje, mirë se keni ardhur në takim të fundit për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2025. Konform legjislacionit dhe qarkores buxhetore dhe edhe konform vullnetit të kryetarit që buxhetin ta vejmë nëpër vija sipas kërkesave tuaja edhe sipas kufijve fillestar dhe qarkores përfundimtare.

Pjesë nga diskutimi i qytetarëve


Gentiana Zeqiri: A e keni paraparë ndriçimin publik në Klinikë të Ullës, tjera pse nuk eliminohen mbeturinat afër fushës sportive ndihmëse dhe për fund a e keni paraparë buxhetin për subvencione nga zyra për baraz gjinore.

Taulant Kadriu: Përshëndetje, a kish pas mundësi që në pjesën e pasatme të platosë në sallën e sportit Ilaz Kodra të shtohet edhe 200 ulëse sepse kemi rritje të shkueshmërisë dhe mendojmë me të hyrjen me pagesë.

Ismet Aliu: Mbeturinat do të eliminohen nga Dshp-ja në bashkëpunim me Unitetin dhe Eko Natyren, subvencionet nga zyra për barazi gjinore do të diskutohen me drejtorin e administratës, ndriçimi në Klinikë kryhet para vjeshtës, sa i përket ulësve nuk kemi planifikim buxhet por mbetet ta vlerësojmë për vitet e ardhshme sepse aty duhet me të edhe një vlerësim të thellë.


Nëse nuk ka pyetje, sugjerime apo propozime, ju falënderoj për pjesëmarrjen.

Procesmbajtësi: Mirsad Gashi





Nr.
No. 02-060/01-0-51731/24
Dati
Data 12. 02. 2024



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET
PËR VITET 2026, 2027

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së, Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim në Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për hartimin e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027

Procesi i hartimit të buxhetit është shumë i rëndësishëm për qytetarët e komunës së Skenderajt, të cilët nëpërmjet propozimeve dhe kërkesave për investime kapitale për vitin e ardhshëm, bëhen pjesë e vendimmarrjes në komunitetin e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të mbahen me datat 21 dhe 22 gusht, sipas kalendarit të detajuar.

Në këto takime mund të marrin pjesë qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve, organizatat e shoqërisë civile, komunitetet e ndryshme, grupe të caktuara të interesit, gratë, pensionistët, të rinjtë, klubet sportive, përfaqësues të komunitetit të biznesit, etj.

Nr.	Dëgjimi buxhetor me qytetarë për hartimin e buxhetit 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027	Dita/data e mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Vendi i mbajtjes	Ora
1.	Dëgjim buxhetor	E mërkurë, 21 gusht 2024	Kl në e Epërme, në Shkollën "Içriz Berani"	13:30
2.	Dëgjim buxhetor	E mërkure, 21 gusht 2024	Rurik, në Shkollën "Shotë Gaca"	15:30
3.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Turqec, në Shkollën "Abedin Rexha"	13:30
4.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Salla e Kuvendit Komunal, Kati IV	15:00

Komentet, kërkesat dhe sugjerimet lidhur me procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027, mund t'i dërgoni në emailat: smet.aliu@ark-s-gov.net dhe jeton.rushiti@ark-s-gov.net



Admir Lushtaku

Udhëheqës për Komunikim me Publikun